



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1106/ 16 prot.

Datë 10.07.2025

V E N D I M
Nr. 885/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 816/2025, datë 27.06.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-37027-02-06-2025, me objekt: Loti 1: “Mobilje për përdorim zyre dhe ambjente të tjera” me fond limit 51,832,236.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “Shaga” SHPK me NIPT J96822229J dhe adresë: Tirane, Rruga Hamdi Pepo, Ish Parku Industrise

“Muça” SHPK me NIPT K01421002H dhe adresë: Tirane, Vore, Picar ,Fshati Picar, Autostrada Tirane - Durres Km.13

“RO-AL” SHPK me NIPT J61811001M dhe adresë: Tiranë, Vorë, Piramida -Vorë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë

Subjekti i Interesuar: Ilir Kaso p.f me NIPT L62420034C dhe adresë:Tirane, Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km.8, godina me zone kadastrale nr 2105, pasuri nr.78/45

“Shaga” SHPK me NIPT J96822229J dhe adresë: Tirane, Rruga Hamdi Pepo, Ish Parku Industrise

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.816/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Shaga” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-37027-02-06-2025, me objekt: Loti I: “Mobilje për përdorim zyre dhe ambjente të tjera” me fond limit 51,832,236.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Muça” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
5. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar dhe të rikthejë për vlerësim zërin me nr. 47 “Sirtarierë metalike”.
6. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Shaga” SHPK, “Ro-AL” SHPK dhe “Muça” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Shaga” SHPK, “Ro-AL” SHPK dhe “Muça” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1485/6 prot., datë 09.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1106/13 prot., datë 10.07.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 08.07.2025 “Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit “Loti I: “Mobilje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera.”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1485/6 prot., datë 09.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1106/13 prot., datë 10.07.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 08.07.2025 “Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit “Loti I: “Mobilje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera.”

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk e ka zbatuar plotësisht vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Në nenin 24 pika 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit;”*.

Ndërsa në nenin 118 pika 2 e po këtij ligji parashikohet: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”*

II.4. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të K.P.P. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimmarrjes së organit kolegjal bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër vendimmarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimmarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë.

II.5. Në pikën III.1.1 të vendimit nr. 816/2025 datë 27.06.2025 për zërin nr. 13 “Dollap rrobash për zyra (një kanat)” duke ju referuar vendimmarrjes së KSHA së autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik ankimues “Shaga” SHPK, ajo ka pranuar pretendimet e ankimuesit për këtë zë dhe për këtë fakt KPP është shprehur: *“Sa më sipër KPP do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Shaga” SHPK bazuar në nenin 115 të LPP-së dhe do të vazhdojë shqyrtimin në themel për pjesën tjetër të saj.”*

Nga verifikimet në raportin e auditit rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shaga” SHPK lidhur me zërin nr. 13 “Dollap rrobash për zyra (një kanat)”. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shaga” SHPK për zërin e sipërcituar në përputhje me vendimmarrjen e KSHA dhe me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr. 816/2025 datë 27.06.2025.

II.6. Në pikën III.5.5 të vendimit nr. 816/2025 datë 27.06.2025 KPP është shprehur se; *“[...] Konkretisht nga verifikimi i tyre rezulton se jepet informacion për standartet: **SSH EN 527-1:2011**; **SSH EN 527-2:2016**; **SSH EN 527-2:2016+A1:2019**; **SSH EN 13721:2004**; **SSH EN 1335-1:2021**, **SSH EN 1335-2:2018** por nuk jepet informacion për standartet **SSH EN 13721:2004**, **SSH EN 1116:2018**, **SSH EN 13310:2015+A1:2018**, **SSH EN 14434:2010**, **SSH EN 1729-1:2015**, **SSH EN 17292:2012+A1:2015** (EN, e njëllefshme ose e përditësuar), **SSH EN 13759:2012**, **SSH EN 1334:1996** standarte këto të kërkuara në specifikime teknike.[...]*

Nga verifikimet në raportin e auditit rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shaga” SHPK lidhur me informacionin mbi standartet e kërkuara në specifikime teknike. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shaga” SHPK lidhur me standartet në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr. 816/2025 datë 27.06.2025.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-37027-02-06-2025, me objekt: Loti 1: “Mobilje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera” me fond limit 51,832,236.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht Vendimin Nr. 816/2025, datë 27.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

